

**V E N D I M**  
**Nr.407, datë 19.6.2003**

**PËR PAGAT NË AVOKATURËN E SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.2000 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Pagat e avokatëve në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit dhe në zyrat vendore të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pagat e funksioneve politike dhe të punonjësve të administratës së Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit dhe të zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003 e në vazhdim, miratuar për Avokaturën e Shtetit dhe për zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit.

4. Vendimi nr.640, datë 22.11.2001 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e Avokaturës së Shtetit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.9.2003.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

Lidhja nr.1

**PAGAT E AVOKATËVE DHE NDIHMËSAVOKATËVE TË SHTETIT NË  
AVOKATURËN E PËRGJITHSHME TË SHTETIT NË ZYRAT VENDORE**

|            | <b>EMËRTESAT</b>                                                    | <b>PAGAT MUJORE</b> |
|------------|---------------------------------------------------------------------|---------------------|
| <b>I.</b>  | <b>Në Avokaturën e Përgjithshme</b>                                 |                     |
| 1.         | Avokati i Përgjithshëm i Shtetit                                    | 180 000 lekë        |
| 2.         | Avokati i Shtetit dhe Sekretari i Përgjithshëm                      | 150 000 lekë        |
| 3.         | Ndihmësavokati i Shtetit në<br>Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit | 65 850 lekë         |
| <b>II.</b> | <b>Në zyrat vendore</b>                                             |                     |
| 1.         | Avokati i Shtetit pranë Gjykatës së Apelit                          | 83 400 lekë         |
| 2.         | Avokati i Shtetit                                                   | 65 850 lekë         |
| 3.         | Ndihmësavokati i Shtetit                                            | 50 490 lekë         |

Lidhja nr.2

**PAGAT E FUNKSIONEVE POLITIKE DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS  
NË AVOKATURËN E PËRGJITHSHME TË SHTETIT DHE NË ZYRAT VENDORE**

**I. Në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit**

**EMËRTESATPAGAT MUJORE**

1. Shefi i kabinetitII-a
2. KëshilltarII-b
3. Shef sektoriIII-b
4. SpecialistëIV-a
5. Sekretar i Avokatit të Përgjithshëm, sekretarIV-a
6. Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm IV-a

## II. Në zyrat vendore

1. Sekretar i Avokatit të Shtetit pranë Gjykatës së ApelitIV-a

Për këto funksione, paga mujore është sipas lidhjes nr.1 të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për strukturat dhe nivelet e pagave të punonjësve civilë në institucionet e administratës qendrore, të administratës së Presidentit dhe të Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore ...”.”.

Punonjës të tjerë

EmërtimiKlasa

1. Arkivist/protokollist, llogaritar, arkëtarVII
2. MagazinierIV
3. ShoferIV
4. Nëpunës informacioniIII

Për këta punonjës zbatohet vendimi nr.726, datë 21.12.2000 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve buxhetorë” dhe pagat sipas lidhjes II/M “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”.